

KËSHILLI KOMBËTAR I ARKEOLOGJISË

Nr. 1004 Prot.

Tiranë, më 27.09 2016

**VENDIM Nr. 101, datë 14.09.2016**

Në mbështetje të Ligjit nr. 9048, datë 07.04.2003, "Për Trashëgiminë Kulturore" (i ndryshuar), Neni 47, VKM Nr. 725, datë 21.05.2008 "Për përbërjen, funksionimin, kompetencat dhe mënyrën e shpërblimit të anëtarëve të Këshillit Kombëtar të Arkeologjisë" (i ndryshuar), Këshilli Kombëtar i Arkeologjisë në mbledhjen Nr. 11 të datës 14.09.2016, pasi shqyrtoi Raportin e rezultateve të shpimeve gjeoteknike në stacionin e kompresorit ACS 03, në Seman Fier, realizuar nga JOINT VENTURE "RENCO spa TERNA" dhe në vijim të tij Raportin e Vëzhgimit Arkeologjik Sipërfaqësor, në kuadër të projektit "TAP" për "Stacionet e Kompresorëve SKSH 02 (ACS 02) Vishoticë, Devoll dhe SKSH 03 (ACS 03) Seman, Fier", konceptin e sondazheve arkeologjik në këto zona -subjekti "TAP AG", realizuar nga shoqëri e licencuar në arkeologji "ABKONS" sh.p.k.,

**VENDOSI:**

1. Të miratojë Raportin e rezultateve të shpimeve gjeoteknike në stacionin e kompresorit ACS 03, në Seman Fier, realizuar nga JOINT VENTURE "RENCO spa TERNA".
2. Të miratojë në vijim të tij, Raportin e Vëzhgimit Arkeologjik Sipërfaqësor, në kuadër të projektit "TAP" për "Stacionet e Kompresorëve SKSH 02 (ACS 02) Vishoticë, Devoll dhe SKSH 03 (ACS 03) Seman, Fier", konceptin e sondazheve arkeologjik në këto zona -subjekti "TAP AG", realizuar nga shoqëri e licencuar në arkeologji "ABKONS" sh.p.k.
3. Investitori "TAP AG" për kryerjen e sondazheve arkeologjike në zonën e Stacionit të Kompresorit në Vishovicë, Devoll dhe gërmimit arkeologjik sipas gjurmëve të strukturave të mbetjeve të furrave (Kaminave), në zonën e Stacionit të Kompresorit në Seman, sipas konceptit dhe metodologjisë të paraqitur nga shoqëria e licencuar në arkeologji duhet të lidhë më parë kontratë tre palëshe me këtë shoqëri dhe Agjencinë e Shërbimit Arkeologjik, e cila do të mbikëqyrë atë. Raporti i tyre do të paraqitet në KKA e radhës.
4. Investitori duhet të derdhë detyrimet tatimore për mbikëqyrjen e realizuar nga ASHA, sipas tarifave të miratuara me Urdhërin e Ministrit Nr. 384, datë 21.10 2015 dhe përcaktimeve përkatëse të kontratës tre palëshe.

5. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.
6. Ngarkohet Sekretaria Teknike për njoftimin e këtij vendimi.

**KRYETAR**  
**MIRELA KUMBARO FURXHI**  
**MINISTËR**



**SEKRETAR I KKA**  
**RUDINA ZOTO**

